# VENDIM
## Nr. 207, datë 20.4.2018

## PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE, TË PJESSHME, TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË NJËSISË ADMINISTRATIVE MBROSTAR URA, BASHKIA FIER, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare, të pjesshme, të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Njësisë Administrative Mbrostar Ura, Bashkia Fier, që transferohen në pronësi ose në përdorim të saj, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit të Njësisë Administrative Mbrostar Ura, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përbëhet nga 14 (katërmbëdhjetë) fletë dhe përfundon me numrin rendor 60 (gjashtëdhjetë).

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryetari i Bashkisë Fier dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

Lidhja 1

Njësia administrative Mbrostar Ura, Bashkia Fier

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1–13 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e arsimit dhe të sportit. | Në pronësi |
| 14–19 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e kulturës. | Në pronësi |
| 20–23 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik. | Në pronësi |
| 24 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës. | Në pronësi |
| 25–29 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike). | Në pronësi |
| 30–37 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile. | Në pronësi |
| 38–45 | Varrezat publike. | Në pronësi |
| 46–52, 54, 55, 57, 58, 53, 56 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta). | Në pronësi |
| 59, 60 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. | Në pronësi |

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

MIRATOHET

Bashkia: FIER
Njesia Administrative: Mbrostar

Fusha e perdorimit te prones:
**Arsim**

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 2636 | 157 | Truall Ndertese | Shkolle 9-Vjeçare, Kopesht femijesh Fshati Mbrostar Ura Njesia Administrative Mbrostar | 4769 | 486 | Arsim parauniversitar | MASH | DA Fier | Kopeshti ndodhet brenda ambjenteve te shkolles |
| 2 | 2944 | 66/12 | Truall Ndertese | Shkolle 9-Vjeçare Fshati Petove Njesia Administrative Mbrostar | 4049 | 423 | Arsim parauniversitar | MASH | DA Fier | |
| 3 | 3695 | 94/61 | Truall Ndertese | Shkolle 9-Vjeçare Fshati Vajkan Njesia Administrative Mbrostar | 9394 | 597 | Arsim parauniversitar | MASH | DA Fier | Brenda Territorit ndodhen dhe ambjentet sportive |
| 4 | 3752 | 49/1 | Truall Ndertese | Shkolla e Mesme e Pergjithshme Kopsht Femijesh Fshati Verri | 9250 | 540 105 | Arsim parashkollor | MASH | DA Fier | Brenda kesaj siperfaqe ndodhen 3 objekte Shkolla, Kopeshti dhe Ambulanca |
| 5 | 3695 | 94/22 | Truall Ndertese | Kopsht Femijesh, ambulance Fshati Vajkan Njesia Administrative Mbrostar | 540 | 173.3 | Arsim parauniversitar | MASH | DA Fier | Ambulanca ndodhet brenda ambjenteve te kopeshtit |
| 6 | 2050 | 100/44 | Truall Ndertese | Shkolle 9-Vjeçare, Kopesht femijesh Fshati Kallm I Madh | 4538 | 880.3 | Arsim parauniversitar | MASH | DA Fier | |